



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria -Vlada-
Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo
Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affair
Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo
Academy for Public Safety
Fakulteti i Sigurisë Publike
Fakultet Javne Bezbednosti / Faculty of Public Safety



KA 01/2018
24.08.2018

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 16 par. 2, të Rregullores (AKSP) nr. 02/2014-KF për kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve dhe në dispozitat e vendimit nr. 3/54, të datës 14.08.2018 të nxjerrë nga Këshilli i Përkohshëm i Fakultetit të Sigurisë Publike, Komisioni Ad hoc për shqyrtimin e ankesave, mori këtë:

VENDIM

1. Komisioni Ad hoc për menaxhim, shqyrtim dhe vlerësim të aplikacioneve të dorëzuara, mbajtjen dhe vlerësimin e provimit pranues për studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike duhet që:
 - 1.1. Të bëjë rivlerësimin e testeve për provim pranues të Grupit B për kandidatët që kanë konkuruar për tu regjistruar si student me përmirësimet e bëra në çelësin (shabllonin) e testit të Grupit B.
 - 1.2. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë një nga kushtet formale të konkursit ku kërkohet së paku tri vite të përvojës së punës në agjensionin punëdhënës duhet të hiqen nga lista e rezultateve preliminare. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtin e sipërpërmendur janë: Labinot Latifi (nr.apl. 000032), Rinor Maloku (nr.apl. 000009), Besart Igrishta (nr.apl. 000122), Ramadan Xhosha (nr.apl. 000014), Ardit Qorrolli (nr.apl. 000097) dhe Florim Hyseni (nr.apl. 000063).
 - 1.3. Të bëhet risistemimi i kandidatëve që kanë aplikuar në mënyrë të gabuar në njësi/departamente që nuk janë pjesë e tyre. Risistemimi duhet të përditësohet (azhurnohet) sipas listave të verifikuara nga agjensioni punëdhënës.
2. Komisioni Ad hoc për menaxhim, shqyrtim dhe vlerësim të aplikacioneve të dorëzuara, mbajtjen dhe vlerësimin e provimit pranues, sipas pikës 1 të këtij vendimi duhet ta përditësojë (azhurnojë) listën e rezultateve preliminare të kandidatëve që kanë konkuruar për tu regjistruar si student në FSP për vitin akademik 2018/2019.
3. Vendimi hyn në fuqi më datën 24.08.2018.

Arsyetim

Me rastin e shqyrtimit të ankesave, Komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve ka ftuar të gjithë kandidatët që kanë paraqitur ankesë për testin e provimit pranues për regjistrim në Fakultetin e Sigurisë Publike. Pas shqyrtimit të të gjithë ankesave të paraqitura pranë këtij komisioni, në mbledhjen e mbajtur më datën 24.08.2018 konstatoi se:

- Çelësi (shablloni) i testit të Grupit B përmban gabime në përgjigjet e dhëna të sakta,

përkatësisht pyetja me përgjigje me numër rendor 22 dhe 27 komisioni për përpilimin e testit për provim pranues në mënyrë të gabuar ka shënuar përgjigje të pasaktë. Duke u bazuar në këtë fakt, Komisioni për pranim ka korigjuar testet e Grupit B me çelës që ka përmbajtur gabime në përmbajtje të përgjigjeve (pyetjet me përgjigje me numër rendor 22 dhe 27), gjë që ka reflektuar në rezultatin përfundimtar të kandidatëve.

- Vërtetohet se disa kandidatë marrë parasysh kushtet e konkursit nuk e plotësojnë përvojën e punës prej së paku 3 viteve deri në ditën e aplikimit për të aplikuar për student.
- Konstatohet se disa kandidat kanë aplikuar në mënyrë të gabuar në njësi/departamente që nuk janë pjesë e tyre, gjë që në listën preliminare të shpallur me datën 16 gusht 2018 janë listuar në departamente/njësi jo përkatëse.

Nga arsyet e cekura më sipër është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Vushtrri, më: 24.08.2018

Komisioni:


1. Halil Asllani, kryeses

2. Besnik Fetahu, anëtar

3. Florentina Shala Braha, anëtare

4. Ferid Azemi, anëtar

5. Rrahim Rexha, anëtar



Nga një kopje e këtij vendimi u dërgohet:

1. Komisioni Ad hoc për menaxhim, shqyrtim dhe vlerësim të aplikacioneve të dorëzuara, mbajtjen dhe vlerësimin e provimit pranues;
2. Ankuesve;
3. Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së;
4. Anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Fakultetit për Siguri Publike;
5. Divizionit për Shërbime Studentore dhe
6. Arkivit të AKSP-së.